

Blerton Sinani, PhD¹

UDC:
342.4

**VËSHTRIM MBI FUNKSIONET E KUSHTETUTËS SI
AKT JURIDIK-POLITIK SUPREM I SHTETIT**

**ОСВРТ ЗА ФУНКЦИИТЕ НА УСТАВОТ КАКО
ВРБЕН ПРАВЕН-ПОЛИТИЧКИ АКТ НА ДРЖАВАТА**

**AN OVERVIEW OF THE FUNCTIONS OF THE CONSTITUTION
AS THE SUPREME LEGAL-POLITICAL ACT OF THE STATE**

Abstract

A constitution is a set of rules by which a country or state is run. In fact, the Constitution is a set of laws and rules that sets up machinery of the Government of a state and which defines and determines the relations between the different institutions and components of the government, the executive, the legislature, the judiciary, the central and the local government. Therefore, the main purpose of this paper is to detect, determine and explain comprehensively specific and distinctive functions of constitution as the supreme and fundamental law of the nation and the state as they are: constitutes the state power and legal order; defines and limits government powers as well as determines and guarantees fundamental human rights and freedoms.

Key words: Constitution, State, Legal Order, Functions of Constitution, Fundamental Human Rights and Freedoms.

¹ Doc. dr. në lëmin shkencor juridik: E Drejta Kushtetuese dhe Administrative në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë. E-mail: blerton.sinani@seu.edu.mk.

1. Hyrje

Shqyrtimet për funksionet e kushtetutës si akt juridik-politik suprem i shtetit bëhen të pamundshme pa një njohuri paraprake të përgjithshme të disa shprehjeve qendrore nga fusha shkencore juridike-konstitucionale. Së këndejmi, nga perspektiva e zhargonit² dhe doktrinës juridike-kushtetuese, është me interes të bëhet një zbërthim dhe sqarim, sado qoftë i përgjithshëm, i domethënies së termave të caktuar: *kushtetutë*, *kushtetutshmëri*, *rend kushtetues* dhe *sistem kushtetues*. Në tekstet universitare, mbase edhe në botime të tjera juridike, haset ekzistenca e një paqartësie të përdorimit dhe mungesa e dallimit të qartë ndërmjet “kushtetutës“, “kushtetutshmërisë”, “rendit kushtetues” dhe “sistemit kushtetues” që, në dukje të parë, lënë përshtypjen se bëhet fjalë për sinonime. Në fakt, shprehjet “kushtetutë”, “kushtetutshmëri”, “rend kushtetues” dhe “sistem kushtetues” u përkasin katër nocioneve juridike diferenciale dhe specifike, prandaj dhe kanë kuptim përmbajtësor distinktiv (të dallueshëm) juridik nga njëri-tjetri. As “kushtetuta”, as “kushtetutshmëria” dhe as “rendi kushtetues” e “sistemi kushtetues” nuk janë sinonime. Pra, sikurse “kushtetutshmëria” që nuk duhet të konfondohet me kushtetutën, ashtu dhe rendi kushtetues nuk duhet të ngatërrohet me sistemin kushtetues dhe të përdoren si sinonime. “Kushtetuta”, në kuptimin më të përgjithshëm, mund të përkufizohet si një akt juridik unik i shkruar dhe i kodifikuar, me fuqi juridike suprale-gale, i miratuar në mënyrë relativisht solemne nga organi sovran ose i veçantë shtetëror, me shumicë të kualifikuar të votave dhe në procedurë të veçantë juridike që dallohet nga procedura juridike për nxjerrjen e ligjeve dhe akteve të tjera normative juridike, me të cilën rregullohen bazat e marrëdhënieve shoqërore e politike, juridike dhe ekonomike, institucionalizon ekzistencën dhe funksionimin e pushtetit shtetëror, garanton liritë dhe të drejtat themelore të njeriut e të shtetasit, dhe si e tillë, është një mjet për kufizimin juridik të fuqisë dhe voluntarismit (arbitraritetit) të titullarëve të pushtetit shtetëror në kuadër të shtetit.³ Dihet se kushtetuta e një shteti përmbledh dhe përcakton parimet juridike më të rëndësishme të organizimit dhe të funksionimit të shtetit. Me të drejtë thuhet se, nëse krahasohet me shtëpinë si një vend i familjes, “kushtetuta është shtëpia e parimeve dhe e normave të

² Me “zhargon juridiko-kushtetues” nënkuptohet “tërësia e termave juridike që përdoren në fushën e shkencës së të drejtës kushtetuese.

³ *Enciklopedija političke kulture*, Beograd, 1993, fq. 1218.

qeverisjes” së një shteti.⁴ “Kushtetutshmëria” ka një kuptim tjetër. Nga “supremacia juridike që ka kushtetuta e një shteti në raport me aktet e tjera juridike të po atij shteti”, buron kuptimi i kushtetutshmërisë. Kushtetutshmëria përbën një parim juridik crucial që proklamon vetë kushtetuta, dhe, si rregull, e përmbajnë kushtetutat e shteteve të ndryshme të botës.⁵ Kuptimi më i përgjithshëm i këtij parimi juridik thotë se “të gjitha ligjet dhe aktet e tjera normative juridike të një shteti duhet të jenë në përputhje me kushtetutën, si aktin më të lartë juridik të tij.”⁶ Në fakt, parimi juridik i kushtetutshmërisë nënkupton se vetëm akti juridik i miratuar nga organi kompetent shtetëror, sipas procedurës juridike të parashikuar me kushtetutë, dhe në përputhje me përmbajtjen e normave kushtetuese, i përmbush postulatet (kërkesat) e parimit të kushtetutshmërisë si në kuptimin formal, ashtu dhe në kuptimin material.⁷ Nocionin e rendit kushtetues e përcakton “uniteti i normave juridike-kushtetuese dhe funksionimi/fushëveprimi real-faktik i të gjithë organeve shtetërore në mbështetje dhe në harmoni me normat juridike-kushtetuese në një shtet dhe shoqëri të caktuar dhe në një moment të dhënë historik”.⁸ Në fakt, rendi kushtetues është uniteti i normatives dhe reales në jetën publike të një shteti dhe, si i tillë, është pjesë integrale e rendit shoqëror të gjithëmbarshtëm të atij shteti. Në përputhje me këtë, “rendi kushtetues” përfshin vetëm atë pjesë të rendit shoqëror, e cila “është rregulluar me normat juridike të së drejtës kushtetuese, si një

⁴ Njohuri për Ligjin – Libër për të gjithë, Tiranë, 2001, fq. 15-29.

⁵ Kështu, p.sh., Kushtetuta e Republikës së Kroacisë e vitit 1990, Neni 5 thotë: *Në Republikën e Kroacisë ligjet duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën, ndërsa të gjitha normat e tjera në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin*”.

⁶ *Pravna Enciklopedija*, Beograd, 1989, fq. 1805. Megjithëse këtë pohim më së miri e ilustron Aleksandër Hamilton (Alexander Hamilton), një nga “etërit” e Kushtetutës së ShBA-së, i cili në vitin 1788 deklaronte: *“Asnjë akt legjislativ që është në kundërshtim me Kushtetutën nuk mund të jetë i vlefshëm. Të mohosh këtë do të thotë të pohosh se vartësi është më i madh se eprori, se shërbetori, është mbi të zotin e vet... Interpretimi i ligjeve është funksioni i mirëfilltë dhe i veçantë i gjykatave. Një Kushtetutë vështrohet në fakt dhe duhet të vështrohet nga gjyqtarët si ligj themelor. Prandaj, u përket këtyre të saktësojnë kuptimin e saj, si dhe kuptimin e çdo akti të veçantë që nxjerr organi ligjvënës... Kur vullneti i legjislaturës, i shprehur në ligjet e saj, vjen në kundërshtim me vullnetin e popullit, të shprehur në Kushtetutë, gjyqtarët duhet të udhëhiqen nga kjo e fundit dhe jo nga ligjet. Ata duhet t’i japin vendimet e tyre në bazë të ligjit themelor, para se t’i japin ato në bazë të ligjeve që nuk janë themelore”*. – cituar sipas Anthony Bradley, Keith Ewing, *Constitutional and Administrative Law*, London, 2003, fq. 5.

⁷ Branko Smerdel, Smiljko Sokol, *Ustavno Pravo*, Zagreb, 2006, fq 162-163.

⁸ Александар Фира, *Уставно Право*, Beograd, 1987, fq. 14.

degë e së drejtës”. Duke studiuar rendin kushtetues, ç’është e vërteta, studiohet sistemi i normave juridike që rregullojnë materien juridike-kushtetuese (*materia constitutionis*), por edhe marrëdhëniet shoqërore e politike mbi të cilat lindin (krijohen) normat juridike-kushtetuese dhe impakti (ndikimi) i tyre në lindjen (krijimin) dhe përmbajtjen e atyre normave, si dhe influenca e normave juridike-kushtetuese në ndryshimin e marrëdhënieve shoqërore.⁹ Mbi këtë bazë, nxirret përfundimi se “nëpërmjet rendit kushtetues vihet në pah uniteti ose lidhja dialektike ndërmjet “normatives (normave juridike-kushtetuese) dhe reales (praktikës shoqërore) si elemente konstitutive të rendit kushtetues të një shteti të caktuar”. Ndryshe nga rendi kushtetues, sistemi kushtetues zakonisht përdoret për të sinjifikuar normat juridike (si përjashtim edhe rregulla të tjera) të përmbajtura në akte të ndryshme normative juridike që rregullojnë materie me natyrë përmbajtësore juridike-kushtetuese. Sistemi kushtetues është një nocion inkluziv (gjithpërfshirës), i cili përfshin normat juridike të numërta dhe të shumëllojshme, përmbajtja e të cilëve i referohet së drejtës kushtetuese si degë e së drejtës. Me shprehjen më të shkurtër të mundshme, sistemi kushtetues është përkuftizuar si “sistem i normave juridike dhe të rregullave të tjera që rregullojnë marrëdhënie dhe çështje me vlerë dhe rëndësi konstitucionale në sistemin juridik të një shteti të caktuar”.¹⁰

2. Funkcionet e kushtetutës

Ideja që të gjitha normat juridike-kushtetuese kardinale duhet të sistemohen dhe të ekspozohen në një akt normativ juridik unik të cilit do t’i jepet status special, më saktësisht fuqi juridike supraleqale, zanafillën e ka qysh nga shekulli XVIII.¹¹ Në këtë drejtim, që nga shekulli XVIII deri më sot, përveçse në disa shtete, në periudha historike të caktuara (ku ajo është devaluuar në tërësi, sidomos në ato vende ku primar ka qenë shteti e jo njeriu, ku primare ka qenë partia politike dhe prijësi i saj e jo shtetasit, ku primare ka qenë ideologjia e jo drejtësia, liria, barazia e mirëqenia e njeriut, siç ishte rasti me shtetet totalitare

⁹ Александар Фира, Маријана Пајванчић, *Основе Уставног Права*, Нови Сад, 1989, fq. 15.

¹⁰ Josip Sruk, *Ustavno Uređenje Socijalističke Federativne Republike Jugoslavije*, Zagreb, 1976.

¹¹ Nurko Pobrić, *Ustavno Pravo*, Mostar, 2000, fq. 91.

qoftë fashiste, qoftë socialiste), në vendet me rend shtetëror të zhvilluar, kushtetuta është trajtuar si dokument themelor juridik-politik i shtetit.¹²

Funksionet e kushtetutës janë të shumëfishta dhe konsistojnë në rolin dhe misionin që ajo ka në shtet dhe shoqëri dhe në rendin juridik. Funksionet moderne të kushtetutës mund të ndahen në dy grupe. Grupin e parë e përbëjnë funksionet normative të kushtetutës. Ato janë funksionet të cilët mbështeten në faktin se kushtetuta është një tërësi normash juridike. Suksesi i kushtetutës në sendërtimin (realizimin) e këtyre funksioneve, në një masë të madhe, varet nga kualiteti normativ i përmbajtjes së saj. Më pas, konteksti socio-politik nuk mund të injorohet (anashkalohet). Funksionet më të rëndësishme normative të kushtetutes janë: 1) funksioni i konstituimit të pushtetit shtetëror dhe rendit juridik; 2) funksioni rregullativ apo organizativ; 3) funksioni i konstitucionalizimit (kornizimit/kufizimit) të pushtetit shtetëror. Grupin e dytë e përbëjnë funksionet sociologjike të kushtetutës. Ato janë funksionet që mbështeten në faktin se kushtetuta nuk është vetëm akt juridik, por edhe një fenomen shoqëror sa kompleks aq edhe delikat. Funksioni i legjitimizimit: 1) funksioni simbolik dhe funksioni integrativ i përkasin këtij grupi.¹³

Kur është fjala për funksionet normative të kushtetutës, në vend të parë është funksioni i konstituimit të pushtetit shtetëror dhe rendit juridik. Në kuptimin e vet burimor, termi “kushtetutë” nënkupton aktin e krijimit dhe vendosjes së rendit juridiko-shtetëror. Sipas teorisë së kontratës sociale, kushtetuta është shprehje juridike e kontratës fiktive nëpërmjet të së cilës nga gjendja natyrore (e parregulluar) stihike shoqërore, pra parashtetërore kalohet në gjendjen e rregulluar shoqërore, pra në gjendjen shtetërore.¹⁴ Për më tepër, kushtetuta përbën substratin inicial juridik-politik në mbështetje të së cilës konstituohet edhe shteti, edhe e drejta. Rrjedhimisht, kushtetuta “është interlokutore”, apo “një urëlidhje” ndërmjet “shtetit” dhe “së drejtës”, nëpërmjet saj në mënyrën më optimale sublimohet raporti mes shtetit dhe së drejtës. Në këtë mënyrë, “e drejta e shtetit assesi nuk mund të jetë e tij”, po qe se “me kushtetutë nuk rregullohet dhe përcaktohet subjekti që do ta krijojë të drejtën, në çfarë procedure juridike atë do ta nxjerrë, dhe në çfarë forme juridike do ta shpreh të drejtën” dhe anasjelltas, “shteti assesi nuk mund të ketë të drejtën e tij”, nëse “me kushtetutë nuk vendosen bazat e organizimit dhe të funksionimit të vet atij shteti”. Prandaj, ka shumë të

¹² Kurtesh Saliu, *E Drejta Kushtetuese*, Prishtinë, 1998, fq. 47.

¹³ Дарко Симовић, Владан Петров, *Уставно Право*, Београд, 2018, fq. 23

¹⁴ Ibidem.

vërtetë në pohimin se “kushtetuta është fundamenti dhe korniza juridike-politike në bazë të së cilës shënohet pikënisja e ndërtimit, zhvillimit dhe funksionimit edhe i shtetit, edhe i së drejtës”.¹⁵ Funksioni konstitutiv i pushtetit shtetëror nga kushtetuta argumentohet me faktin se kushtetuta si akt juridik etablon organet më të larta dhe më të rëndësishme të pushtetit shtetëror të një shteti të caktuar që përbëjnë “elitën e organeve të pushtetit shtetëror të një shteti të caktuar”, siç janë: parlamenti, shefi i shtetit, qeveria, gjykata kushtetuese, organet e judikaturës/gjyqësorit dhe ombudspersoni/avokati i popullit. Bëhet fjalë për organet shtetërore qendrore të një shteti të caktuar që janë më autoritative dhe, si të tilla, kanë vlerë dhe rëndësi vitale për ekzistencën, organizimin dhe funksionimin e pushtetit shtetëror të një shteti të caktuar, të cilët shtrijnë dhe ushtrojnë juridiksionin e vet në gjithë territorin e shtetit dhe ndaj tërë popullsisë së shtetit. Nga ana tjetër, si ligj më i lartë, si ligj themelor i shtetit, kushtetuta është akt me anë të cilit vendoset gurthemeli i rendit juridik. Prandaj, rendi juridik pa kushtetutë është “vendosje e kulmit” pa themelin në të cilin do të mundte të mbështetej dhe qëndrojë ai. Në përputhje me atë që u theksua sipër, resulton se nëpërmjet kushtetutës konstituohet nga pikëpamja juridike edhe pushteti shtetëror, edhe rendi juridik. Pra, pushteti shtetëror dhe rendi juridik janë kreacione juridike-politike të kushtetutës dhe jo anasjelltas. Mirëpo, është e gabuar të konsiderohet se kushtetuta me vetë faktin e ekzistencës së vet ta realizojë këtë funksion. Mund të ndodhë që sistemi kushtetues i parashikuar me kushtetutë ose institucione të caktuara të tij asnjëherë të mos e shohin “dritën e ditës“, d.m.th. të mos aplikohen në praktikë. Kushtetuta e tillë shprehur figurativisht është “e lindur e vdekur“. Në histori, e tillë ka qenë, fjala vjen, Kushtetuta e Francës e Montanjarit e vitit 1793.¹⁶

Funksioni i dytë normativ i kushtetutës është funksioni rregullator apo organizativ. Kushtetuta është e shprehur në definicionet si në vijim: Kushtetutat janë kodekse të normave që synojnë të rregullojnë alokacionin (distribucionin) e pushtetit dhe funksionet e institucioneve të ndryshme dhe titullarëve të pushtetit shtetëror si dhe rregullojnë marrëdhëniet midis tyre dhe shtetasve. Kushtetuta trason “hartën e pushtetit“ (*power map*); kushtetutat definojnë strukturën e pushtetit shtetëror, orientojnë rrugëtimin e pushtetit dhe procedurën e miratimit të ligjeve.¹⁷ Si një ndër burimet themelore të së drejtës në përgjithësi dhe i së drejtës

¹⁵ Миодраг Јовичић, *О Уставу*, Београд, 1977, fq. 7-8.

¹⁶ Дарко Симовић, Владан Петров, *Уставно Право*, Београд, 2018, fq. 23.

¹⁷ Ibidem, fq. 23-24.

kushtetuese në veçanti, kushtetuta është jo vetëm bazë juridike dhe kornizë normative për konstituimin dhe funksionimin e organeve shtetërore, por edhe burim i kompetencave të tyre, pra bazë për funksionimin e sistemit politik, si tërësi e institucioneve shtetërore qendrore të një shteti, por edhe mbrojtëse nga arbitrariteti eventual i tyre.¹⁸ Në një kuptim të caktuar, ky funksion i kushtetutës sot në mënyrë inadekuante dhe të padrejtë është anatemuar. Sartori, megjithatë, tërheq vemendjen se ajo është vetë esenca e kushtetutës. Kushtetuta pa katalogun e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut e të shtetasit, sipas Sartorit, akoma është kushtetutë, por kushtetuta pa dispozitat mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit shtetëror, ajo më nuk është kushtetutë.¹⁹

Funksioni i tretë normativ i kushtetutës është konstitucionalizimi i pushtetit ose “kufizimi efikas i pushtetit shtetëror në interes së lirisë”. Këtë funksion të kushtetutës e ka identifikuar autori i Deklaratës Franceze për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit të vitit 1789: “*Shoqëria në të cilën të drejtat e njeriut nuk janë garantuar dhe ndarja e pushteteve nuk është përcaktuar, nuk ka një kushtetutë*” (neni 16).²⁰ Edhe pse kushtetutat e para të shkruara janë miratuar pikërisht me qëllim që pushtetin ta konstitucionalizojnë, në shekullin XIX dhe në gjysmën e parë të shekullit XIX jetësimi i konstitucionalizimit ka qenë kushtetuta “e pashkruar” angleze. Kushtetutat formale, nëse përjashtohet Kushtetuta e SHBA-ve e vitit 1787, kanë pasur pak fat me konstitucionalizmin. Ato kanë bërë përpjekje në zbulimin dhe gjetjen (sigurimin) e baraspeshës kushtetues. Tendenca e sforcimit faktik, por edhe juridik e pushtetit ekzekutiv ka dobësuar besimin në fuqinë e kushtetutës si një instrument të kufizimit të pushtetit politik. Shumë konsiderojnë sot se kushtetutat formale janë të padobishme. Nëse titullarët e pushtetit vetë vetveten e kufizojnë, kushtetutat e shkruara janë të panevojsme, dhe nëse ato këtë nuk e bëjnë ato janë të padobishëm (S. E. Finer, V. Bogdanor, B. Rudden). Është i njohur krahasimi i kushtetutës formale (së shkruar) me bravën e dyerve. Këto brava të dyerve janë të panevojshme për njerëzit e ndershëm, por në mënyrë të njëjtë janë të pafuqishme të dekurajojnë (pengojnë) hajdutin e vendosur për të vjedhur. Megjithatë, ato mund të pengojnë hajdutët e zakonshëm, të cilët sikur të mos ishin bravat e dyerve do të hynin dhe merrnin gjësende të

¹⁸ Kurtesh Saliu, *E Drejta Kushtetuese*, Prishtinë, 1998, fq. 47.

¹⁹ Дарко Симовић, Владан Петров, *ver. e cit.*, fq. 24.

²⁰ Luan Omari, Aurela Anastasi, *E Drejta Kushtetuese*, Tiranë, 2008, fq. 10.

caktuara. Prandaj, kushtetuta e mirë, e shkruar me dorën e një kushtetutëvënësi të mençur dhe të shkathët, i pranuar nga pjesëtarët e bashkësisë shtetërore, mund të jetë një mjet efikas kundër arbitrarizmit dhe voluntarizmit të qeverisësve. Në çfarë mase kushtetutëvënësi do ta realizojë këtë rol varet edhe nga kultura kushtetuese e shtetit konkret. Kultura kushtetuese është shprehje superiore juridike politike e vetëdijes kolektive të popullit. Mosekzistenca e kësaj kulture kushtetuese e degradon (devalvon) edhe kushtetutën më të mirë formale.²¹

Nëpërmjet kushtetutës vendosen norma juridike për ushtrimin e pushtetit shtetëror, në mënyrë që ky pushtet të mundet të ushtrohet konform atyre normave juridike të vendosura që më parë dhe jo sipas vullnetit arbitrar dhe subjektiv të qeverisësve, d.m.th. aludohet dhe insistohet në konstitucionalizimin e pushtetit shtetëror. Konstitucionalizimi i pushtetit shtetëror nënkupton postulatit (kërkesën) për vënien e sjelljeve të gjithsecilit, duke përfshirë këtu edhe kushtetutëvënësin nën kushtetutë (*government under the constitution*) si akt juridik fundamental dhe suprem i shtetit të caktuar. Në kuptimin më të përgjithshëm, konstitucionalizmi do të thotë kufizim juridik i pushtetit politik nga Kushtetuta dhe nënshtrim i shtetit ndaj së drejtës.²² Në fakt, konstitucionalizmi është negacion i absolutizmit dhe arbitrarizmit, i cili përdoret për të treguar lëvizjen e tërë të luftës për miratimin e kushtetutës së shkruar dhe kufizimin dhe institucionalizimin e pushtetit shtetëror, përcaktimin dhe mbrojtjen juridike të lirive dhe të drejtave të shtetasve.²³ Në këtë drejtim, burimi dhe kufizimi juridik i pushtetit shtetëror nga kushtetuta tregon dhe dëshmon se kushtetuta qëndron mbi pushtetin shtetëror, d.m.th. se pushteti shtetëror duhet t'i nënshtrohet kushtetutës. Së këndejmi, edhe pse në shumicën dërrmuese të shteteve parlamenti është titullar i funksionit kushtetutëvënës e ligjvënës dhe organ demokratik reprezentativ i shtetasve, ai nuk qëndron mbi kushtetutën. Përkundrazi, kushtetuta është mbi parlamentin, pra parlamenti qëndron nën kushtetutën dhe brenda kornizave të saj. Kjo do të thotë se kushtetuta është me potente ose më e fuqishme se parlamenti, edhe pse parlamenti në praktikën juridike-konstitucionaliste paraqitet, parimisht dhe praktikisht, si një nga subjektet kryesore që bën miratimin e saj. Përderisa kushtetuta e pengon dhe e kufizon arbitrarizmin dhe voluntarizmin e

²¹ Дарко Симовић, Владан Петров, *Уставно Право*, Београд, 2018, fq. 24.

²² Luan Omari, *Ndarja e Pushteteve dhe Pavaresia e Institucioneve Kushtetuese*, Tiranë, 2011, fq. 10.

²³ Kurtesh Saliu, *E Drejta Kushtetuese*, Prishtinë, 2004, fq. 91.

parlamentit, ligjet e pengojnë dhe e kufizojnë arbitrarizmin dhe voluntarizmin e organeve shtetërore ekzekutive-administrative dhe gjyqësore.²⁴ Po ashtu, intenca e kushtetutës është të sigurojë që pushteti shtetëror të ushtrohet në pajtim me interesin publik (interesin e përgjithshëm shoqëror) dhe të mirën e përbashkët të të gjithë shoqërisë dhe jo vetëm në interes dhe në dobi të qeverisësve ose, siç kanë pohuar autorët e shkollës së të drejtës natyrore, të transponojnë në aktin kushtetues kontratën sociale origjinale (burimore), sipas së cilës pushteti shtetëror duhet të ushtrohet në interesin e përbashkët dhe në dobi të të gjithë shtetasve.²⁵ Në këtë kuadër, është me interes dhe rëndësi të vihet në dukje fakti se konstitucionalizmi rrënjët ideore i ka kryesisht te shkolla e së drejtës natyrore dhe teoria e kontratës sociale të cilat janë zhvilluar në shekullin XVII dhe XVIII.²⁶

Kushtetuta pajton kontradiktat themelore midis autoritetit dhe lirisë. Përderisa autoriteti simbolizon pushtetin shtetëror, liria personifikon individin. Konkiliacioni (pajtimi) midis pushtetit shtetëror dhe individit paraqet një problem specifik të së drejtës kushtetuese, ngase kushtetuta si akt juridik siguron organizimin e pushtetit shtetëror, d.m.th. përcakton marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe shtetasve, qeverisësve dhe të qeverisurve. Në përputhje me këtë, njëri nga autorët e njohur të së drejtës kushtetuese në Francë, Andre Orju (Andre Hauriou), kushtetutën e ka kualifikuar si teknikë e konkiliacionit (pajtimit) midis pushtetit shtetëror dhe lirisë së individit brenda territorit të një shteti. Kjo nënkupton se esenca e kushtetutës konsiston në kufizimin reciprok midis pushtetit shtetëror dhe lirisë së individit: pushteti shtetëror të kufizohet me lirinë e individit dhe anasjelltas, liria e individit të kufizohet me pushtetin shtetëror. Flitet për vendosjen e balancit midis pushtetit shtetëror dhe lirisë së individit brenda kornizës së organizatës shtetërore. Në këtë drejtim, balanci midis lirisë së individit dhe pushtetit shtetëror është çështje shumë delikate. Kjo për shkak se liria e individit pa pushtetin shtetëror bëhet kaos, anarki (*bellum omnium contra omnes*), ndërsa pushteti shtetëror pa lirinë e individit bëhet pushtet opresiv (despotik) ose totalitar.²⁷ Kjo mbase le të kuptohet se kuptimi

²⁴ Branko Smerdel, Smiljko Sokol, *Ustavno Pravo*, Zagreb, 2006, fq. 49.

²⁵ Драган Стојановић, *Уставно Право*, Ниш, 2004, fq. 52-53.

²⁶ Veljko Mratović, Nikolla Filipović, Smiljko Sokol, *Ustavno Pravo i Političke Institucije*, Zagreb, 1989, fq. 26.

²⁷ Nurko Pobrić, *Ustavno Pravo*, Mostar, fq. 22-23; Драган Стојановић, *Уставно Право*, Ниш, 2004, fq. 6-7.

shoqëror i thellë përmbajtësor dhe rëndësia demokratike qenësishme e kushtetutës është që, në kuadër të shtetit, të organizojë koekzistencën e qetë dhe harmonike midis pushtetit shtetëror dhe lirisë së individit. Së këndejmi, nxirret përfundimi se liritë dhe të drejtat e njeriut janë indikator kryesor për marrëdhëniet midis individëve dhe pushtetit shtetëror. Ato janë mjete për sigurimin e simbiozës së pushtetit shtetëror dhe të individëve në lidhjen “dramatike” që ekziston midis tyre. Liritë dhe të drejtat e njeriut janë instrumente për mbrojtjen e individëve nga shteti dhe nga individët e tjerë, d.m.th. instrumente për kufizimin e pushtetit shtetëror dhe njëherësh janë kategoria qendrore e konstitucionalizmit. Krahas kësaj, në regjimet politike demokratike, kushtetuta si akt juridik me fuqi juridike supralecale, ka për objektin bosht: “të sigurojë supremacinë e së drejtës mbi organet e pushtetit shtetëror si qeverisës në kuadër të shtetit, pra të sigurojë sundimin e së drejtës dhe t’i garantojë dhe t’i mbrojë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut e të shtetasit. Kjo sikur e vërteton tezën e njërit nga teoricienët e spikatur të së drejtës kushtetuese në Francë, Zhak Kadar (Jacques Cadart), se sundimi i së drejtës dhe i lirisë së individit është i mundshëm vetëm nëpërmjet ekzistencës së kushtetutës si akt juridik.”²⁸

Çdo kushtetutë, në një masë më të vogël ose më të madhe, e realizon funksionin simbolik. Kushtetuta është simboli i parë i shtetit të pavarur e të mëvetësishëm dhe është shprehje e sovranitetit të popullit. Prandaj, forma e shkruar e kushtetutës dhe sovraniteti i popullit janë bërë sinonime ideologjike dhe politike. Nëpërmjet kushtetutës, shteti, në raport me shtetet e tjera, legjitimohet si pushtet sovran apo suprem në territorin e vet, që ka pëlqimin e popullit²⁹ që të qeveris në atë territor mbi ata, dhe që shtetasit në atë territor t’i gëzojnë liritë dhe të drejtat themelore.³⁰ Ajo mund të jetë simbol i përfundimit të suksesshëm të luftës për pavarësi ashtu siç ka qenë rasti me kushtetutat e para moderne formale, Kushtetutën e ShBA-së së vitit 1787, por edhe me shumë kushtetuta të miratuara në Afrikë dhe Azi në procesin e dekolonizimit. Kushtetuta mund të jetë “kurora” juridike e revolucionit shoqëror-

²⁸ Павле Николић, *Уставно Право*, Београд, 1997, fq. 18.

²⁹ Qeverisje me pëlqimin e popullit d.m.th. “parlament i zgjedhur, me përbërje nga përfaqësues të atyre që i kanë zgjedhur me votën e tyre, nëpërmjet të të cilit organi përfaqësues ka autoritetin zyrtar për të qeverisur. – Cituar sipas Llambro Filo, *Historia e Kohëve Moderne*, Tiranë, 2006, fq. 44.

³⁰ Shih: Ратко Марковиќ, *Уставно Право и Политичке Институције*, Београд, 2008, fq. 87.

politik ashtu siç është rasti me Kushtetutën e Francës së vitit 1791. Në instancë të fundit, çdo kushtetutë është konfirmim, të paktën formal, se një entitet mund të konsiderohet shtet. Shtetet në lindje dhe krijim e sipër, gjithmonë, si rregull, nxitojnë të nxjerrin kushtetutat e veta të para, ndërkaq shtetet në tranzicion të nxjerrin kushtetutat e veta “demokratike” nëpërmjet të së cilave shtetet, para së gjithash dhe mbi të gjitha, afirmohen në marrëdhëniet me botën e jashtme. Kushtetuta angleze ka qenë simboli më i fortë i fuqisë koloniale të perandorisë angleze. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, shumë vende të botës kanë pretenduar ta kenë rregullimin kushtetues anglez. Kushtetuta angleze³¹ ka qenë simbol i konstitucionalizmit, balancit

³¹ Edhe pse Anglia nuk ka kushtetutë të shkruar, si dokument unik juridiko-politik i miratuar në mënyrë solemne me fuqi juridike supralegale, vështruar nga prizmi historik, ajo ka avantazh në zhvillimin e konstitucionalizmit. Parimit romako-bizantin sipas të cilit mbreti ishte “legibus solutus” (i palidhur ose i pakushtëzuar nga ligjet), iu kundërvu parimi i shpallur në Angli qysh nga shekulli XII, sipas të cilit mbreti qëndron nën Perëndinë e nën ligjin, sepse ligji e bën mbretin – “*sub Deo et sub lege, quia lex facit regem*”. Mbi bazën e këtij parimi u zhvillua e gjithë doktrina juridiko-konstitucionale angleze, që mbështetet në epërsinë e së drejtës (*rule of law*). Edhe pse Anglia sot e kësaj dite nuk ka një kushtetutë të shkruar dhe të kodifikuar, d.m.th. materia kushtetuese në Angli nuk është e përmbledhur dhe e sistemuar në një akt unik kushtetues, me të cilin do të përcaktoheshin bazat e rregullimit shoqëror dhe shtetëror. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se Anglia nuk ka të drejtën kushtetuese. Përkundrazi, ajo ka të drejtën kushtetuese, edhe si degë të së drejtës, edhe si disiplinë shkencore, madje ka edhe sistem kushtetues të zhvilluar. E drejta kushtetuese në këtë shtet përbëhet nga një mori konventash kushtetuese e dokesh kushtetuese, si rregulla shoqërore të pashkruara, si dhe nga akte të numërta dhe të shumëllojshme të karakterit kushtetues, sidomos ligjesh të vjetra e të reja, si norma të shkruara. Në fakt, në Angli gjenden “rrënjët e para” të konstitucionalizmit modern ose, shprehur ndryshe, në Angli fillon rruga zhvillimore e konstitucionalizmit bashkëkohor sepse në të janë nxjerrë dokumente të shumta me natyrë përmbajtësore juridiko-kushtetuese, ndër të cilat, më të rëndësishme janë: *Magna Carta Libertatum* e cila është nxjerrë në vitin 1215, *Petition of Right* në vitin 1628, *Agreement of the People* në vitin 1647, *Habeas Corpus Act* në vitin 1679, *Bill of Rights* në vitin 1689, *Act of Settlement* në vitin 1701. Ndonëse nuk është fjala për kushtetutën si akt juridik i shkruar me fuqi juridike më të lartë, idetë dhe parimet të cilat ato akte (dokumente) të sipërpërmendura i kanë shprehur dhe anticipuar janë parime mjaft sinjifikative dhe domethënëse të konstitucionalizmit, mbase edhe kanë pasur ndikim të madh në paraqitjen e kushtetutave të para të shkruara dhe zhvillimin e konstitucionalizmit në botë. Gjithashtu, Anglia është vendi i parë në të cilin në vitin 1653 është paraqitur dokumenti i parë i sistematizuar, që përmbledh normat dhe parimet mbi rregullimin shoqëror dhe shtetëror i emërtuar *The Instrument of Government* – Instrumenti i Qeverisjes, i cili pa të drejtë konsiderohet si kushtetutë e parë e shkruar në historinë e konstitucionalizmit mondial ngase nuk ka hyrë në fuqi, dhe, për pasojë, nuk është zbatuar në praktikë, ndonëse pas këtij dokumenti kushtetues të shkruar dhe të kodifikuar, në Angli asnjëherë nuk është nxjerrë kushtetutë e shkruar. Është me rëndësi të theksohet se përveç akteve të

kushtetues, jetës së organizuar politike; ajo është simbol i gjenialitetit politik anglez. Një nga kushtetutat që sot në mënyrë të theksuar (spikatur) sendërton funksion simbolik është Ligji themelor i Gjermanisë i vitit 1949, si kushtetutë që është nxjerrë si akt i përkohshëm, në kushtet dhe rrethanat të cilët e kanë destinuar në rrënimin e shpejt dhe harresën e tij. Sot kjo kushtetutë është simbol i një triumfi madhor juridikë, politikë e ekonomikë të popullit gjerman. Edhe më shumë se kaq, ajo është simbol i kushtetutës moderne në të cilën normat mbi të drejtat e njeriut si dhe normat mbi organizimin e pushtetit në dy nivele (Republikës Federative të Gjermanisë dhe shteteve-anëtare si njësi federale konstitutive të bashkësisë shtetërore federative) mirë të balancuara, guardian suprem i së cilës është gjykata kushtetuese autoritative.³²

Funksioni i legjitimitetit të kushtetutës është i domosdoshëm dhe i justifikuar. Kushtetuta është një mjet i legjitimitetit demokratik të pushtetit shtetëror, si dhe një mjet me të cilën sigurohet në një masë më të vogël ose më të madhe, progresi dhe paqja sociale dhe përparon mirëqenien publike (*salus publica*) të të gjithë anëtarëve të shoqërisë politike të organizuar në shtet.³³ Subjektet-miratuuese të kushtetutës, përkatësisht subjektet politike që kanë marrë pjesë në marrëveshjet rreth kushtetutës, legjitimohen me autoritetin dhe përmbajtjen e asaj kushtetute. Është e qartë se kushtetuta nuk mund të jetë ndryshe (tjetër) nga kreatori i saj. Nëse kushtetuta ka tekst normativ kualitativ që në mënyrë të njëjtë mban llogari-kujdes mbi rregullimin e ndarjes së pushtetit dhe garancitë për të drejtat e njeriut, dhe më pas i korrespondon shoqërisë për të cilën është nxjerrë, ajo është vepër e kushtetutvënësit të matur (kujdesshëm). Megjithatë, nëse kushtetuta është “plotë” me demokraci e të drejta të njeriut dhe tekst të zbrazët e kontradiktor, është vepër e

përmendura më lartë, burime të tjera të së drejtës kushtetuese në Angli janë edhe këto akte: *Ligji mbi Unionin me Skocinë* (1706); *Ligji mbi Unionin me Irlandën* (1800), *Ligji mbi Parlamentin* (1911 dhe 1949); *Ligji mbi Gjykatën Supreme të Drejtësisë* (1925); *Statuti i Uestminsterit* (1931); *Akti mbi ministrat e Monarkut* (1937, 1958, 1964 dhe 1975); *Akti mbi pavarësinë e Indisë* (1947); *Ligji mbi gjyqësinë* (1960); *Akti mbi vetadministrimin lokal* (1972), etj. Të gjitha këto akte, pavarësisht nga rëndësia e tyre përmbajtësore për nga fuqia juridike janë ekuivalente me ligjet e rëndomta. Kjo lejon mundësinë të kuptohet se Anglia nuk ka kushtetutë në kuptimin formal, pra nuk ka kushtetutë të fortë (ngurtë), por ka kushtetutë në kuptimin material, pra ka kushtetutë të butë (fleksibile). - Për më tepër shih: Lidija Basta, *Politika u Granicama Prava*, Beograd, 1984, fq. 26-38; Šefko Kurtović, *Povijest Prava i Države*, Zagreb, 2002, fq. 6-56.

³² Дарко Симовић, Владан Петров, *Уставно Право*, Београд, 2018, fq. 25.

³³ Ратко Марковиќ, *Уставно Право и Политичке Институције*, Београд, 2008, fq. 88.

manipulantit (mashtguesit) politik. Funkzioni legjitimues i kushtetutës sot shpeshherë abuzohet. Teksti i keq normativ, i shkruar për një kohë të shkurtër, jorallë me ndihmën e ekspertëve të huaj që nuk i njohin kushtet dhe rrethanat interne socio-ekonomike e politike, të përkrahur me kampanjë të fuqishme mediatike, resulton të miratohet në referendum. Kjo nuk është kushtetutë reale popullore; ajo është vetëm një iluzion i kushtetutës së tillë.^{34, 35}

Ekziston një funksion i kushtetutës që nuk është i ri, por në shkencën e së drejtës kushtetuese shpeshherë është anashkaluar. Fjala është për funksionin integrativ. Kushtetuta është konditë e unitetit shtetëror. Ashtu siç paraqesin simbolet shtetërore faktor integrativ dhe unifikativ të një shteti të caktuar, edhe kushtetuta përbën një faktor integrativ dhe unifikativ të atij shteti në përgjithësi.³⁶ Diter Grim e eksplikon këtë funksion në mënyrën si vijon: Kushtetuta konsiderohet garanci e

³⁴ Ibidem.

³⁵ Bëhet fjalë për kuptimin sociologjik të kushtetutës si akt juridik. Në lidhje me këtë, në librin e tij “*Mbi esencën e kushtetutës*”, Ferdinand Lasal-i (Ferdinand Lassalle), e argumenton kuptimin sociologjik të kushtetutës në mënyrë figurative-metaforike. “Kur në kopshtin tuaj ju keni një dru molle dhe varni në të një skedë në të cilën shkruani: kjo është fiq, a është bërë me këtë rast druri i mollës fiq? – Jo, por edhe sikur të mblidhnit të gjithë anëtarët e shtëpisë, rrethin familjar, madje edhe gjithë popullsinë e vendit dhe të betoheni solemnisht dhe me zë të lartë: kjo është fiq – druri mbetet prapë ai që ka qenë, dhe menjëherë vitin që vjen do të tregohet si i tillë: do të japë molla si fryte, e assesi fiqa. Po sikurse me drurin e mollës, ashtu ndodh edhe me kushtetutën. Sado që të jetë e shkruar kushtetuta në një listë prej letre, është gjë krejtësisht irelevante nëse vetë ajo është në kontradiktë me gjendjen reale të gjërave, raportet objektive (faktike) të forcave të cilat ekzistojnë në një shtet dhe shoqëri”. Në fakt, sipas Lasal-it pikërisht raportet reale (faktike) të forcave të cilat ekzistojnë në një shtet janë kushtetuta “e gjallë”, e vërtetë e tij. Ato janë forca operative dhe aktive të cilat i përcaktojnë të gjitha normat juridike. Për këtë arsye, çështjet kushtetuese nuk janë çështje të së drejtës, por çështje faktike, kështu që kushtetuta reale (faktike) e një shteti ekziston vetëm në marrëdhëniet reale (faktike) të cilat veprojnë në një shtet. Në dallim nga kushtetuta reale apo faktike, kushtetuta juridike nuk është gjë tjetër veçse veshja e atyre raporteve faktike (reale) me formën dhe forcën e dokumentit juridik të shkruar. Kushtetutat e shkruara, siç pohon, Lasal-i, janë me vlerë dhe jetëgjatë vetëm atëherë kur janë shprehje ekzakte dhe objektive e konstelacionit (raportit) real (faktik) të forcave të cilat ekzistojnë në një shtet dhe shoqëri. Në qoftë se kushtetuta nuk e përmbush një kërkesë të tillë, atëherë ajo është vetëm një listë letre e thjeshtë. Nga kjo rezulton se, kuptimi sociologjik, shikimin e vet “e drejton” në “bërjen e Kushtetutës” një realitet. Ndryshe, nocioni sociologjik i kushtetutës ka lindur si pasojë e diskrepancës ndërmjet “normatives (normave juridike-kushtetuese)” dhe “reales (praktikës shoqërore)”, në kuptimin e kushtetutës formale (së shkruar). - Ferdinand Lasal, *O Suštini Ustava*, Beograd, 1907, fq. 52.

³⁶ Драган Стојановић, *Уставно Право*, Ниш, 2004, fq. 52-53.

konsensusit fundamental që është i nevojshëm për shkak të kohezionit shoqëror. Nëse kushtetuta është e suksesshme në aspektin e kohezionit shoqëror, atëherë kushtetuta mund madje t'i ndihmojë formësimin të identitetit shoqëror. Kushtetuta atëherë shërben si dokument në të cilën shoqëria i shprehën bindjet dhe kërkesat esenciale. Ky aspekt i kushtetutës mund të kualifikohet dhe trajtohet si funksioni integruar i tij. Çdo kushtetutë nuk e realizon këtë funksion. Kjo nuk varet nga kualiteti normativ. A do të jetë kushtetuta një nga faktorët vendimtar të integritetit shoqëror varet, në një masë më të madhe, nga dy momente. Njëri moment është objektiv dhe ka të bëjë me atë që kushtetuta duhet të përmbajë dhe shpreh vlerat themelore dhe aspiratat e një shoqërie. Momenti tjetër është subjektiv dhe i përket vetëdijes së pjesëtarëve të një komuniteti lidhur me atë se kushtetuta, realisht dhe praktikisht, i shpreh vlerat dhe kërkesat përkatëse. Pra, për funksionin integruar është e nevojshme që shtetasit ta pranojnë kushtetutën si “të veten”,³⁷ si pasqyrë e qëllimeve të veta, por edhe si një instrument i qenësishëm për arritjen e tyre. Kushtetuta mund të jetë një tekst normativ i mirë i cili zbatohet, por me të cilën shtetasit nuk identifikohen. Ajo kushtetutë atëherë do të realizonte shumicën e funksioneve të veta normative, por jo edhe funksionin integruar. Megjithëse nuk ekziston shoqëri në të cilën kushtetuta ka një rol të tillë të rëndësishëm në integrimin shoqëror, siç është ajo në ShBA, dhe si shembuj të kushtetutave të reja me funksion të spikatur (theksuar) integruar është Ligji Themelor i Gjermanisë i vitit 1949 dhe Kushtetuta e Zvicrës e vitit 1999. E kundërta,

³⁷ Kushtetuta është vepër e traditës dhe e ndërgjegjes (vetëdijes) së popullit që krijohet nëpër shekuj: “Në kushtetutë shteti duhet t'i ndërthurë detyrimisht të gjitha marrëdhëniet e tij. P.sh., Napoleoni, donte spanjollëve, *a priori*, t'u jepte kushtetutë, që shkonte shumë keq. Kjo për shkak se kushtetuta nuk është kreaturë e thjeshtë: ajo është vepër e shekujve, e ideve dhe e ndërgjegjes (vetëdijes) për atë që është e mirë dhe që është zhvilluar në një popull. Prandaj, asnjë kushtetutë nuk e krijojnë subjektet në mënyrë të thjeshtë. Atë kushtetutë që Napoleoni ua dha spanjollëve ishte më e mirë se kushtetuta që ata e kanë pasur më parë, mirëpo ata atë kushtetutë e hodhën poshtë duke e trajtuar si diçka heteronome (të huaj), sepse nuk ishin të edukuar (arsimuar) për atë kushtetutë. Në bazë të kësaj që u parashtua më lart, rezulton përfundimi se kushtetutën një shteti dhe shoqërie të caktuar, si rregull, nuk mund “t'ia sjellë” askush tjetër, përveç se populli i saj. Secili shtet veç e veç e ndërton kushtetutën në pajtim me mundësitë që krijon dhe, para së gjithash, me shkallën e vetëdijesimit të popullit, për ta kuptuar dhe, për ta ndërtuar atë në jetën e vet. Standardet konstitucionale të një vendi ose të më shumë vendeve nuk mund të vlejnjë si standarde të përgjithshme për të uniformuar vende të tjera.- Светомир Шкарик, *Македонско и Споредбено Уставно Право*, Скопје, 2004, fq. 151-152.

kushtetutat të cilat nuk e kanë arritur (fituar) “kapacitetin” integrues në histori kanë qenë të gjithë kushtetutat e Francës deri te kushtetuta e fundit e vitit 1958. Në këto hapësira, kushtetuta që ka qenë faktori më i madh dezintegrues i shoqërisë ka qenë Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974. Kohëve të fundit, mbi funksionin integrues më së shumti flitet në dritën e idesë mbi të ashtuquajturën kushtetuta evropiane.³⁸

Më në fund dhe përfundimisht, kushtetuta është shprehje e gjendjes zhvillimore kulturore të shtetit dhe shoqërisë së caktuar, mjet fundamental me anë të cilit tregohet dhe matet shkalla kulturore e popullit të caktuar, pasqyra e trashëgimisë së tij kulturore dhe themeli i shpresave të dhe vlerave juridike civilizuese universale të tij, siç janë: liria, paqja, demokracia, pluralizmi politik, barazia, drejtësia, dinjiteti i njeriut, respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut, sundimi i së drejtës etj.³⁹

3. Conclusion

The constitution is the basis for achieving and securing of justice. It is the basis for the harmonization of the various legal acts in a state; a legal expression and guarantee for the existence and constitutionality of a given state. Its degree of respect, and the efficient legal instruments for its protection are a reflection of the degree of democracy and respect of fundamental rights of citizens. In addition the constitution is both the main, and the most important legal regulator of basic social and political relations within the framework of the legal system of the state. Through the approval of the constitution as the primary and original legal act in the legal order of a certain country it is realistically expressed as, *first*, the legal and political subjectivity of an independent and sovereign state within certain territorial boundaries, *second*, established as the cornerstone of the national legal order, *third*, popular sovereignty and unity are inaugurated and reflected within it, and *fourth*, it is proclaimed, guaranteed and exists as the fundamental freedom and rights of man and citizen. These are both natural and inalienable; not donated by the state.

Recensentë:

Prof. dr. Bajram Pollozhani

Prof. dr. Mersim Maksuti

³⁸ Дарко Симовић, Владан Петров, *Уставно Право*, Београд, 2018, fq. 26.

³⁹ Peter Häberle, *Ustavna Država*, Zagreb, 2002, fq. 16.

REFERENCAT:

1. *Enciklopedija političke kulture*, Beograd, 1993;
2. *Njohuri për Ligjin – Libër për të gjithë*, Tiranë, 2001;
3. *Pravna Enciklopedija*, Beograd, 1989;
4. Anthony Bradley, Keith Ewing, *Constitutional and Administrative Law*, London, 2003;
5. Александар Фира, *Уставно Право*, Beograd, 1987;
6. Александар Фира, Маријана Пајванчић, *Основе Уставног Права*, Нови Сад, 1989;
7. Branko Smerdel, Smiljko Sokol, *Ustavno Pravo*, Zagreb, 2006;
8. Дарко Симовић, Владан Петров, *Уставно Право*, Josip Sruk, *Ustavno Uređenje Socijalističke Federativne Republike Jugoslavije*, Zagreb, 1976;
9. Дарко Симовић, Владан Петров, *Уставно Право*, Београд, 2018;
10. Драган Стојановић, *Уставно Право*, Ниш, 2004;
11. Ferdinand Lasal, *O Suštini Ustava*, Beograd, 1907;
12. Kurtesh Saliu, *E Drejta Kushtetuese*, Prishtinë, 1998; Београд, 2018;
13. Lidija Basta, *Politika u Granicama Prava*, Beograd, 1984;
14. Luan Omari, *Ndarja e Pushteteve dhe Pavaresia e Institucioneve Kushtetuese*, Tiranë, 2011;
15. Llambro Filo, *Historia e Kohëve Moderne*, Tiranë, 2006;
16. Миодраг Јовичић, *О Уставу*, Београд, 1977;
17. Nurko Pobrić, *Ustavno Pravo*, Mostar, 2000;
18. Nurko Pobrić, *Ustavno Pravo*, Mostar, 2000;
19. Павле Николић, *Уставно Право*, Београд, 1997;
20. Peter Häberle, *Ustavna Država*, Zagreb, 2002.
21. Ратко Марковиќ, *Уставно Право и Политичке Институције*, Београд, 2008;
22. Šefko Kurtović, *Povijest Prava i Države*, Zagreb, 2002;
23. Светомир Шкарик, *Македонско и Споредбено Уставно Право*, Скопје, 2004;
24. Veljko Mratović, Nikolla Filipović, Smiljko Sokol, *Ustavno Pravo i Političke Institucije*, Zagreb, 1989;